



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:037887

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06725089

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, i përbërë nga kryetari i trupit gjykues Ilir Bytyqi, anëtarët e trupit gjykues Mimoza Maloku dhe Shabi Idrizi, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.G dhe F.G nga Ferizaj, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.19/23 të dt.04.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të dëmtuarit N.Lme av. mbrojtës Gazmend Rexhepi, të akuzuarve A.G me av. mbrojtës Fitim Shabani dhe F.G me av. mbrojtës Urim Bajraktar, gjykata me datë 12.12.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.01.2025, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1. A.G i lindur me datë 27.04.1973, nga babai E dhe nëna E. e vajzërisë S., me vendbanim në rrugën “.....” pn. Ferizaj, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar dhe prind i katër fëmijëve, me numër personal “.....”.
2. F.G i lindur më datë 23.11.1974, nga babai E... dhe nëna E..... e vajzërisë S..... , me vendbanim në rrugën “.....” pn. Ferizaj, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pamartuar, me numër personal “.....”.

JANË FAJTOR

Të akuzuarit: A.G dhe F.G

Sepse nga viti 2017 deri më datë 10.02.2023, në lokalitetin e tyre të përbashkët “Toni” në Ferizaj, kanë kontraktuar shuma dukshëm joproporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër duke shfrytëzuar papërvojën e të dëmtuarit N.L, në atë mënyrë që në periudha të ndryshme kohore ia japin 27,000.00 Euro (njëzet e shtatë mijë), ndërsa i dëmtuari në emër të borxhit kryesor dhe kamatës (fajdes) deri më tani ka paguar 57,000.00 Euro (pesëdhjetë e shtatë mijë euro), mirëpo të pandehurit e kanë detyruar të dëmtuarin që të nënshkruar në një fletore se gjoja iu ka borxh edhe 73,000.00 Euro (shtatëdhjetë e tremijë euro), por gjatë bisedave i pandehuri A.G i kërkon shumën fikse 63,000.00 Euro (gjashtëdhjetë e tremijë euro) me kusht që shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro) do ti falë.

Me çka kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje fajdeja nga neni 331 par. 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, në bazë nenit 331 dhe neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 42, 43, 69, 70 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, i

G J Y K O N

- Të pandehurin A.G dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 /dy/ vite, të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
dhe
- Dënim me gjobë në shumë prej 1000 Euro /një mijë/, të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Të pandehurin F.G dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. dhe
- Dënim me gjobë në shumë prej 1000 Euro /një mijë/, të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

- Në rast se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk e paguan dënimin në të holla, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro të papaguar, do t'i llogaritet një /1/ ditë burg.
- Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar të akuzuarit A.G i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.02.2023 deri më datë 07.04.2023, ndërsa të akuzuarit F.G i llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga data 10.02.2023 deri më 07.04.2023.
- Konform, nenit 269 par.1 lidhur me nenin 271 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme parat në shumën prej 4945 Euro /katërmijë e nëntëqind e katër dhjete e pesë euro/, 280 Euro /dyqind e tetëdhjetë euro/ dhe 200 SF /dyqind franga zvicerane/.
- I dëmtuari: N.L me vendbanim në rrugën “.....” pn. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohen të akuzuarit konform nenit 450 dhe 452 të KPPK-së, në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 200 Euro /dyqind euro/, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën secili veta vet nga 50 Euro /pesëdhjetë euro/, në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.19/23 të dt.04.04.2023, ndaj të pandehurve A.G dhe F.G nga Ferizaj, për shkak të veprës penale ne bashkëkryerje fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të rënda, pas pranimit të kësaj lënde, ka vepruar sipas kësaj çështje penale duke mbajtur shqyrtimet gjyqësor me datë 09.10.2024, 31.10.2024, 22.11.2024 dhe 10.12.2024, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka mbet pran aktakuzës dhe kualifikimit

ligjor, ndërsa të pandehurit dhe avokatët mbrojtës kanë propozuar të lirohen nga akuza për veprën penale që u vihet në barrë.

Deklarimi për fajësinë apo pafajësinë

Të akuzuari A.... dhe F.G, në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se: nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale në bashkëkryerje fajdeja nga neni 331 par. 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari A.G, me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: punoj me mobil shop nga viti 2002, ndërsa N.L e njoh nga viti 2015-2016 sepse i njëjti ka punuar në një mobil shop “.....” dhe i kemi servisuar telefonat dhe në këtë mënyrë kemi filluar bashkëpunimin dhe kemi krijuar raporte nga të cilët kanë lindur detyrimet e ndërsjellta por jo më tepër se shumat 1000€, 2000€ dhe 3000€ për shkak të biznesit që kemi bashkëpunuar. Me kalimin e kohës raportet me N..... kanë avancuar ashtu që kemi pirë kafe dy-tri herë në ditë.

Lidhur me obligimin në shumën prej 63.000 Euro që N..... në ka, nuk ka të bëj me veprimtarin e servisimit apo shitjen e telefonave mobil, por në realitet ky borxh është krijuar në fillim të vitit 2021, kur N..... më ka propozuar një biznes për distribuimin e kafes ku i kam dhënë shumën prej 25.000€ për investim dhe si garancion më ka ofruar banesën në rast dështimi, biznesi kafes i ka dështuar N..... gjoja se e ka tradhtuar një person nga Shqipëria, por N..... prapë më tha se e kam gjete një biznes tjetër me disa sprej për pastrim dhe mi kërkoj edhe 25.000 euro për të investuar. Pas dy apo tre muaj mi ka kërkuar huazim edhe 6000€ për ta ndërruar laminatin në banesë, pas katër muaj mi ka kërkuar huazim edhe 4000€ për ti ndërruar dyert dhe dritaret e banesës në mënyrë që kur ti vije djali nga Austria le ta sheh banesën e re, pas pak ka ardhë në lokal i ka marr edhe dy telefona në vlerë 700-800 Euro dhe disa para cash dhe këtu e kemi rrombullaksu shumën totale të borxhit ekuivalente me banesë 63.000 euro, po N..... banesën nuk e kishte në emër të vetin por kishte një kontratë interne me shitës, bile bile më ka udhëzuar ta thirri djalin e tij që ti them “ma ka dhënë një banesë në “Fush Kosovë” dhe tash jemi zero zero (barazuar). Nga fillimi i vitit 2022 N.... ka filluar të më shmanget dhe nuk mundesha ta kontaktoj dhe për shkak të problemeve që më krijoj u detyrova ta shes truallin tim prej 6 ari.

Pas kësaj periudhe që nuk mund ta takoja N....., një ditë rastësisht e takove në rrugën “Astrit Bytyqi” dhe më thotë “kam qenë në luftë në Ukrain dhe më kanë mbyll legjioni Francës”

e pyeta pse nuk po më përgjigjesh ai më tha “kesh te djali Xheles për mi marr 30.000€ kinse me mi sjell por kishte do telashe financiare e nuk mundi t’i bëj” por merri ti diku huazim unë ti jap më tepër 10.000€ që mos të dëmtohem apo ta shes pronën dhe pas dy-tri dite e kemi lënë të takohemi për çka e njoftova se i kam gjete 10.000€ për çka në fillim të vitit 2023 duhet me pagu detyrimin a në fakt unë nuk i kisha gjete këto para por i thash me qëllim të ma përmbush obligimin për dijeni kjo shuma e fundit arritke totalin e borxhit 73.000€ për të cilin nuk kam pretenduar ta marr. Parat e sipërcekura unë u kam marr nga dy baxhanakët e mijë A.... dhe I.H nga fshati Gabrricë të cilit jetojnë dhe veprojnë në Zvicër.

Në lidhje me F.... raportet qëndrojnë se ky është vetëm pronar juridik me letra ndërsa unë jam pronari faktit i biznesit, F..... vetëm shet telefona, mbushje fizike, blen deviza edhe e furnizon lokalin me telefona, F..... me N..... nuk kanë pasur raporte dhe pa më pyet mua F..... kurr nuk i ka dhënë diçka N..... Ndërsa në lidhje me mbishkrimin në fletore në shumën prej 73.000€uro që N..... ka ndaj meje unë nuk e dijë kush e ka bërë, këtë shënim e kam parë vetën ditën më kanë arrestuar.

I akuzuari F.G, me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: merrem me servisim, shitjen e telefonave dhe këmbimin e devizave të cilën veprimtari e ushtroj në lokalin mobil shop “Toni” biznesi është në emër tim ndërsa e menaxhon A..... N..... e njoh kohë të gjatë qysh kur ka punuar në mobil shop “Off On”.

Po, ka pas raste kur A..... më ka thirr në telefon dhe më ka thënë jepi N..... telefon dhe 650 Euro para cash si dhe mbushje telefoni herë pas here, unë asnjë herë nuk i kam kërkuar borxh N..... çoftë edhe për telefonin të cilin ai kisha dhënë me herët. Për ndyshe jetoj në bashkësi familjare dhe ekonomike me A.....n. Vonë e kam kuptuar që N..... ka marrë pare nga A.....

Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën e penale për pikën I të cilën e ngarkon akuza prokurorit të shtetit, gjykata ka bërë paraqitjen e provave materiale dhe personale e veçmas pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve – parave me datë 10.02.2023;
- nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve – telefonave mobil të pandehurve me datë 10.02.2023;
- nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht me datë 10.02.2023;
- nga fotografit e bëra të parave të sekuestruara nga të pandehurit;
- nga shikimi i fletores së punë me mbishkrimin KEK, në të cilën është konstatuar shuma 73.000 Euro obligimi i N..... deri më datë 15.01.2023;
- raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga forenzika rajonale me datë 10.02.2023 dhe raporti informues lidhur me rastin 2023-CFI-15 ose PP.I.19.23 të dt.11.02.2023;
- zbatimi i masave të veçanta hetimore fotografim i fshehtë ose vëzhgim në vende publike dhe monitorim i fshehtë i bisedave në vende publike.
- nga dëgjimi i të dëmtuarit N.L, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit A..... dhe F.G, të dhënë në procedurën hetimore dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht, gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- të pandehurit i kanë huazuar dy here nga 25.000 Euro të dëmtuarit, disa telefona celular dhe disa mbushje fizike për telefon, fakte këto të konfirmuara nga vetë të pandehurit;
- nga veprimet si më lartë shuma totale ka arritur vlerën prej 63.000 Euro të huazimit, për tu barazuar me të dëmtuari janë dakorduar të marrin banesën si ekuivalent për kompensimin të principalit dhe intersit;
- në fletoren e punë të të pandehurve e cila mban mbishkrim KEK, është konstatuar se detyrimi i të dëmtuarit N..... është 73.000Euro, por që 10.000€ ai falin me kusht që të përmbush obligimin në shumën 63.000Euro, dorëshkrimi është me laps kimik dhe i nënshkruar;

- nga masat e veçanta hetimore fotografimi i fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike dhe monitorim i fshehtë i bisedave në vende publike në ditën e arrestimit kur i dëmtuari paguan një pjesë të interesit ose kamatës në shumën prej 1000 Euro, në emër të fajdejes, policia i arreston në flagrancë të pandehurit.

Andaj, në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarve përkatësisht vërtetimi i faktit se a ishte i akuzuari kryerësit e veprës penale të fajdeje ashtu siç i ngarkon pika e akuzës.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit – të dëmtuarit N.L, vërtetohet se i dëmtuari njihet me të pandehurit rreth 7-8 vite më parë pasi që kanë bashkëpunuar lidhur me sevisimin e telefonave, A... dhe F..... i kanë sjell telefonat mobil për servisim më pas kanë filluar të shoqërohen, ndër kohë i dëmtuari ka shitur shtëpinë dhe pagesa i është bërë me këste dhe ky ka qenë momenti kur ka filluar të marrë hua nga të pandehurit. Fillimisht në vitin 2017 ka marrë hua shumën prej 2000 Euro për një javë kthimi mirëpo nuk ka mundur ti kthej por ai ka dhënë 50 Euro për një darkë si shenjë të vonesës por F..... i përgjigjet “kthemi paret sepse ti e din që punoj me deviza dhe më ke dëmtuar shumë” i dëmtuari i përgjigjet “sa të kam dëmtuar të kompensojë” pra ishte vonuar katër muaj dhe ka për të paguar nga 200 Euro për muaj në total i bije principali dhe dëmi apo shtesa 2800Euro.

Dëshmitari vërteton se në ditët kur ka filluar të ndërtoj një shtëpi në fshatin “.....” K. Ferizaj, ka huazuar nga F..... shuma prej 100€, 200€ dhe 500€ për pagesa të materialëve ndërtime dhe ky i fundit i thotë “N..... cysh po kërkon borxh kur borxhin e mëparshëm nuk e ke larë” i dëmtuari i përgjigjet “kadal se kur të më paguhet pjesa tjetër që kam shitë shtëpinë do ti jap” ashtu që pak nga pak dhe me shtesa ishin dakorduar që totali i borxhit të jetë 10.000 Euro, deri në këtë shumë F..... nuk ka përmendur interes apo kamat por nëse ka luajt shuma për pak gjithmonë e kanë bërë fiks. Në ndër kohë ai blerësi i shtëpisë nga mbetja N.....t ai kishte paguar shumën prej 15.000 Euro por N..... nuk ia paguan fare borxhin F.....t.

Pas dy muaj nga e gjithë ngjarja e zhvilluar si më lartë në shesh të qytetit takohen rastësisht N..... dhe A....., gjatë bisedës A..... i thotë “ N..... , këto para t’i kam dhënë për shkak të shoqërisë dhe unë për këto para jam tu paguar interes tjetër kund ku i kam marrë” i dëmtuari i është përgjigjur “çka të kam bërë dëm për këtë interes do të rri mbrapa dhe e paguaj”, ashtu që duke llogaritur shuma e borxhit 10.000 euro plus interesi 5.000 euro ne total 15.000 euro, deri në këtë pjese ishte dëshira e te dëmtuarit ta marre përsipër këtë borxh qe mos te dëmtohen F..... dhe A..... Përkundër asaj qe arriti borxhi si me larte i dëmtuari asnjëherë nuk kishte kthyer ndonjë

vlere te borxhit por kur kishte ardhur nga Austria Faiku (Faiku është djali i N.....) dhe i kishte sjelle shumen prej 7.000 eurove këto para N..... ja kishte dhënë A.....t ne restorantin “Orchidea”, ne atë mënyrë qe borxhi ishte zvogëluar dhe kishin mbetur vetëm 8.000 euro, prezent ne kete restorant kishin gene Faik, N..... dhe A....., me këtë te fundit N..... ishte marre vesh qe ti thotë Faikut “tani jemi zero-zero”, por qe ne fakt borxh kishte mbetur edhe 8.000 euro.

Me pas i dëmtuari ka marre një kredi ne shumen prej 5.000 euro ne bankën BPB, këto para ja ka dhënë F.....t dhe borxhi kishte mbetur vetëm 3.000 euro dhe për këtë shume janë marre vesh me F.....n qe te paguajnë nga 300 euro për çdo muaj vonese, për çka i dëmtuari kishte mbetur pa pune sepse ishte ndare nga partneri i biznesit, ne atë mënyrë qe nuk ka mundur te paguaje as borxhin dhe as interesin, kjo pjese e detyrimit i referohet vitit 2018.

I dëmtuari N.L gjate vitit 2019 ka marre nga A..... dhe F..... mbushje te telefonit ne shuma te ndryshme nga 5 euro, 10 euro dhe 15 euro si dhe telefona celular ne shuma nga 100-200 euro, për një vit borxhi përsëri ju është bere 15.000 euro, nga kjo shume i është paguar A.....t 6.000 euro para cash te vendi i quajtur nënkalmi i qytetit, gjate këtij viti i dëmtuari e kishte shitur shtëpinë ne fshatin Llojza dhe ne ndërkohë A..... dhe F..... e thirrshin ne telefon qe te ju paguaj borxhin, nga ky presion i dëmtuari ka pranuar një veture Audi A7 ne vlere prej 55.000 euro ne emër te diferencës se shtëpisë dhe këtë veture e ka shitur për 43.000 euro, blerësi i veturës i ka paguar vetëm 13.000 euro dhe pjesën tjetër kurrë me nuk e ka paguar, 12.000 euro ja ka paguar A.....t edhe pse u tejkalojke shuma e mbetur nga borxhi por A..... i thotë “*qe tash e tutje borxhi tu ka bere 20.000 euro sepse unë kam paguar interes tek njerëzit qe i kam marre ato para*”.

Ne fund te vitit 2021 dhe gjate vitit 2022 i dëmtuari ka bere një marrëveshje me F.S për ta blere një banese ne rrugën “.....”, për ta rinovuar këtë banese A..... ja ka kërkuar huazim edhe 4.000 euro dhe e kemi bere fiks shumen prej 15.000 euro qe unë te i kthej A....., por gjate vitit 2022 unë e morra huazim një veture Passat nga N.SH ne vlere 10.000 euro, këtë veture ja kam dhënë A.....t për vlerën 7.500 euro ne mënyrë qe te zbatohen dhe mbetja e borxhit është zvogëluar ne atë mënyrë qe u be 7.500 euro.

Dëshmitari tutje sqaron se prape ka filluar te marre hua nga F..... dhe A..... shuma nga 200 deri ne 700 euro ne atë mënyrë qe totali i borxhit arriti 7.500 nga mbetja ne 10.000 euro dhe nga ky moment nuk kam mundur me te paguaj kthim te borxhit, periudha kohore i referohet mesit te muajve te vitit 2022, për këtë qellim kane dale dhe kane biseduar me A.....n i cili i thotë “je vonuar ndërsa unë po paguaj kamate” gjithherë ka ardh duke ju rrite borxhi deri ne shumen kur A..... i thotë se borxhi tu ka bere 53.000 euro, kjo kishte ndodhur ne fund te vitit 2022 ku unë kam nënshkruar ne një fletore pune te F..... dhe A....., te cilën ky i fundit me tha nënshkruaj me mire

sa jemi gjallë ta kemi si dëshmi dhe unë e kam nënshkruar me dëshirë, nuk kam qene i kanosur nga këta te dy përveç se me kane telefonuar shpesh duke me bere presion dhe për këtë unë rashe ne depresion.

Sipas dëshmisë se këtij dëshmitari i cili vete konfirmon se kjo pune ne mes te vëllezërve G..... dhe te dëmtuarit personalisht ka shkuar pak si pështjelltë sa qe sa i kane thënë qe ka borxh ka pranuar dhe kur kishte arritur borxhi total prej 53.000 euro i dëmtuari dy muaj nuk ka dale nga shtëpia fare, ashtu që në fillim te vitit 2023 e ka takuar A.....n i ka thënë “kam biseduar me djalin tënd dhe e kam njoftuar se borxhi total është rritur ne 63.000 euro” por A..... ishte arsyetuar te djali i N.....t gjoja se paratë ja kishte dhënë për ta blere banesë dhe për të bërë biznes sepse N..... i kishte shkuar disa here ne shtëpi dhe pas disa muajve kur i dëmtuari N..... e ka takuar A.....n ky i fundit i thotë “shumen totale e ke 63.000 euro për te paguar ndërsa i dëmtuari i kërkon te prese deri ne fund te vitit 2023 me shprese qe do ta shesë banesën për ta paguar borxhin por A..... i thotë “deri ne fund te vitit te ri rritet borxhi ne shumen prej 73.000 euro” ky ishte momenti kur i dëmtuari tani me është lodhur nga kjo shtuate dhe përfundimisht e thirre në telefon A.....n dhe e pyet si po ja bëjmë kësaj shume por A..... i përgjigjet “djalit tënd i kam thënë që 63.000 euro edhe ty po te them 63.000 euro borxh i keni” ndërsa 10.000 euro po ja fali por kur i dëmtuari e ka nxjerre fletoren e tij ku i kishte të evidentuara nga A..... dhe F..... i njofton se po i dalin vetëm 27.000 euro borxh plus i njofton për shumen e parave qe kishte dhënë deri në këtë kohe i dolën gjithsej 57.000 euro që do të thotë 30.000 euro ka paguar më shumë se borxhi, plus të pandehurit i kërkonin shtese edhe 63.000 euro dhe A..... i thotë “hajri dhe zarari janë bashkë edhe unë jam djege 100.000 euro” nga ky moment i dëmtuari i njofton institucionet shtetërore ligj zbatuese.

Nga prova materiale vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve me numër rasti 2023-CFI-15 te datës 10.02.2023, vërtetohet se zyrtari policor #6874 nga hetimet rajonale ne Ferizaj, sekuestroi përkohësisht sendet nga A.G me numër personal 1011630703 edhe atë: 1x100 euro me numër serik WA3179600164, 1x100 euro me numër serik RB1097845988, 1x100 euro me numër serik EA44442602267, 1x100 euro me numër serik RB0682064177, 1x100 euro me numër serik VA1725017744, 1x100 euro me numër serik UD5060779497, 1x100 euro me numër serik RB6943335314, 1x100 euro me numër serik VA4027683115, 1x100 euro me numër serik N15205320174, 1x100 euro me numër serik X13567910798, mjetet e lartshënuara janë marre nga i dëmtuari dhe janë evidentuar dhe fotografuar per tu përdorur me rastin e pagesës se fajdeje.

Nga prova materiale vërtetimi mbi kthimin e sendeve te sekuestruara përkohësisht me numër rasti 2023-CFI-15 te datës 10.02.2023, vërtetohet se zyrtari policor #6874 nga hetimet rajonale ne Ferizaj, i k’thene sendet respektivisht parat të dëmtuarit N.L.

Nga prova materiale vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve – telefonave mobil të të pandehurve të dt. 10.02.2023, respektivisht raporti i ekspertizës nga sektori për fotografi, video analiza dhe ekzaminime të IT-së të datës 24.02.2023, nga imazhet e nxjerra vërtetohet se të akuzuarit aktivitet kanë pas dhënien – marrjen e parave ndaj personave siç janë: marrëveshja ndaj borxhit (obligim) ndaj F.G, me datë 21 Nëntor 2022 / 21.000Euro ja dorëzoi, me datë 25 Dhjetorë / 30.000Euro për këtë vit kaq, pjesa tjetër jetë për vitin 2023 duke filluar nga fundi janarit e nënshkruar nga pësoni V.M.

Më pas personi me N.... (K.M), në bazë të imazheve të nxjerra ne nga tel. samsung, shënohet 23.000Euro me datë 17.09.2020, 1000Euro me datë 15.10.2020, 1500Euro me datë 04.11.2020, 1000Euro me datë 05.02.2021, 1000Euro me datë 25.03.2021, 1000Euro me datë 07.05.2021, 1000Euro me datë 01.07.2021 dhe 1000Euro me datë 01.09.2021. Nga foto imazhet e tjera të nxjerra figuron edhe personi me emrin Buki ka marrë hua nga të pandehurit shumat e evidentuar variojnë 10.980Euro, plus 75Euro, 300Euro, 170Euro, 1500Euro etj. Më pas Fatosi & A..... të nënshkruar nga të dy shumat variojnë 8000Euro me datë 21.02.2020, 7000Euro me datë 26.03.2020, 7300Euro me datë 22.04.2020, 8000Euro me datë 25.05.2020 dhe 7000Euro me datë 23.06.2020. Nga një imazh tjetër i nxjerr nga tel. samsung konstatohet se me datë 23.07.2019 obligimi ndaj F.....t shuma totale 26.000Euro më pas me datë 02.08.2019 obligimi ndaj Ftonit është 40.000Euro i nënshkruar nga pësoni por emrin nuk prezicohet dhe shuma e fundit e nxjerr nga imazhet e tel. konstatohet nga një person si obligim ndaj F.....t shumën 70.000Euro me datë 13.09.2019 është i nënshkruar nga personi por emri nuk precizohet. B.B i cili pohon se ka marrë borxh 8000€ para cash dhe 2000€ telefona e mbushje, B.H pohon se ka marrë borxh 5000Euro, 3000\$, SH.Q pohon se ka marrë borxh gjithsej 10700Euro, G.A pohon se ka marrë borxh 3000-3500 etj. por karakteristik e gjithë këtyre në hetuesi kanë pohuar se nuk kemi paguar interes (deklarimet e tilla a ishin nga frika apo diçka e tillë, këtë rrethanë nuk ka mundur të vërtetohet edhe për këtë qëllim nuk janë propozuar nga organi akuzës të dëgjohen si dëshmitarë).

Nga prova materiale fletorja e punës me mbishkrim KEP, konfiskuar ditën e arrestimit me rastin e aplikimit të masave të veçanta hetimore, është vërtetuar se me datë 31.12.2022 N.L i ka obligim A.G shumën 73.000Euro, është nënshkruar nga N..... dhe afati i fundit për pagës është 15 janar 2023.

Nga prova materiale raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dosja hetimore 2023-CFI-015 të dt.30.03.2023, vërtetohet se në rrugën “.....” në lokalit “TONI” pronë e të pandehurve F. &

A.G të cilët po dyshohen se janë duke ushtruar aktivitetin e fajdejes është bastisur dhe evidentuar e fotografuar të gjithë dëshmitë në vendngjarje, të pandehurit janë shoqëruar në zyrat e hetimeve rajonale dhe gjatë kontrollit të F.... dhe A.G, te ky i fundit janë gjete në xhep shuma e parave nga të cilat i kishte paguar viktimë N.L në emër të fajdes, parat i janë konfiskuar janë fotografuar dhe shënuar numrat e bankënotave për secilën (shiko fotografinë nr.11, 12 dhe 15 të raportit në fjalë).

Nga prova materiale siç janë masat e veçanta hetimore: fotografimi i fshehtë ose vëzhgim në vende publike dhe monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike bartura në CD-të vërtetohet se i dëmtuari shkon në lokalitë të dyshuarve me datë 10.02.2023, ora 13:30, i lexon shumat e parave të huazuara të dyshuari personalisht, A..... i përgjigjet më ke borxh 63.000 Euro ndërsa 10.000 Euro t'i kam heqe për me të ndihmu dhe do më mbesin "garramet në kokë" një fakt tjetër me rëndësi nga këto masa vërtetohet se i dyshuari Agron ka biseduar edhe me djalin e viktimës duke ai konfirmuar shumën e detyrimit 63.000 Euro, A..... ai konfirmon se edhe ky ka borxhe ndaj personave të tretë gjoja ku i ka marrë paratë huazim sepse po të ishte borxh i babës do të ishte krejt tjetër send. Po ashtu A..... e pyet N..... çka ti themi djalit tënd në momentin kur të më thirr në telefon, "i bëjë be në kish e xhami që pare me kamat nuk i kam dhënë dhe nuk kam qef me ma qit emrin që kom dhanë pare me kamat".

Ndërsa me datë 10.02.2023, ora 13:33:05 i dëmtuari N.L i pohon se i ka dalë rroga 1020 Euro, nga kjo shumë 1000Euro ai sjell A..... në emër të borxhit, në ora 13:36:49 A..... i merr paratë dhe fillon të numëroj dhe i vendosë në fiok.

Në ora 13:54 të njëjtës ditë, A..... më pas e sugjeron N..... që ta thërret djalin dhe ti tregoj se qato 63.000Euro ai kam A..... borxh të fundit, nga përmbajtja e bisedës vërtetohet që A..... vetëm se ka biseduar më parë me djalin e N..... lidhur me borxhin e krijuar. A..... i kërkon një shumë 50.000Euro për ta mbyll një vade që ka ndaj personave të tretë pa qare. Në flagrance arrestohet me datë 10.02.2023, ora 13:46:57 nga hetuesit rajonale të Ferizaj.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve A. & F.G

Teoria e mbrojtjes të paraqitur nga të pandehuri dhe avokatet mbrojtës në të gjitha fazat e procedurës penale është përqendruar në kundërshtimin e fakteve se nuk kanë kryer veprën penale të fajdes nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, por gjykata nuk i fali besim për këto fakte vendimtare, në zbatim të masave të veçanta hetimore siç janë fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi në vende publike dhe monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike është vërtetuar se të pandehurit janë marrë me veprimtarin e fajdes, për çka të dëmtuarit N.L i kanë dhënë para me interes në vlera të ndryshme i cili deri më tani ka paguar interes dhe principal (para të marra)

shumë prej 57.000€uro plus po ia kërkonin edhe 63.000€uro, në zbatim të masës ditën e arrestimit i pandehuri A..... pranon një pjesë të pagesës në shumë prej 1000€uro, të cilat i janë zënë në xhep të pantallonave gjatë kontrollimit. Bile bile, i pandehuri A.... e udhëzon të dëmtuarin se si ta arsyeton borxhin të djali i vet në Austri në mënyrë që të paguaj pa asnjë fjalë shumë 63.000€urove.

Të pandehurit dhe mbrojtja nuk ishin në gjendje të ofrojnë prova bindëse për ta argumentuar teorinë e akuzës, këto karakteristika i ndërlidh edhe me provën materiale fletore e punës të të pandehurve ku janë edhe disa emra dhe mbiemra e në raste të caktuara vetëm me nënshkrime por e rëndësishme është shumat e konstatuara si të huazuara siç janë të K.M, V.M, B.B, B.H, Sh.Q, G.A etj. të elaboruar më detalishtë në faqe 10-11. Në rrethana objektive të pandehurit kanë dhënë para huazim (të pandehurit pohojnë se në baza shoqërore dhe pa interes), por në realitet ku qëndron qëllimi i huazimit të këtyre parave siç janë të evidentuara në fletore dhe gjoja se pa interes, nëse merret totali i huazimeve kalon mijëra dhe qindra euro, në krahasim me deklarin gjatë mbrojtjes se punojnë me shitjen e telefonave, mbushjen e telefonave me kreditim dhe blerjen e shitjen e devizave nuk është bindëse dhe e arsyeshme veprimtaria pa lëshimin e fajdeve me interes. Për këto arsyeje nuk i fali besimin mbrojtjes. Ndërsa në ndërlidhje me mbishkrimin në fletore të punës me datë 31.12.2022 N.L, A.G 73.000€ obligim deri më 15 Janar 2023, të pandehuri A. dhe F. gjoja se nuk e dinin nga është shënuar kjo, andaj nga rrethanat si më lart dhe provat e tjera vërtetimet mbi konfiskim, raporti i forenzikës rajonale, fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe ndërlidhke me deklaratën e të dëmtuarit N.L, mbrojtja është jo e bazuar dhe mbështetur në prova bindëse dhe materiale dhe si të tilla nuk i falet besimi.

Vlerësimi i aspektit ligjor

Gjykata, vlerësuar në aspektin juridik në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të fajdes nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohë vend dhe datën siç është përshkruar në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit kanë kontraktin dobi pasurore që ishte në shpërpjesëtim të madh me vlerën e dhënë pasurore sepse të dëmtuarit ai kishin huazuar shumë e principalt 27.000 €uro, sipas evidencës dhe regjistrimit nga vet i dëmtuari kur ka shkuar të barazohet me fletore, ndërsa me interes kishte paguar deri tani 57.000€uro, plus po ai kërkonin edhe 63.000€uro. Nuk është kontestuese se i kanë dhënë parave në formë huaje të dëmtuarit, me afate të pagesës deri në fund të vitit 2023, të cilat rriten në mënyrë marramendëse nëse nuk kthehen në kohë, duke ai rritur më

pas shumën në 73.000€uro, por që nëse do të paguan 63.000€uro do ti falin 10.000€uro, për pasojë i dëmtuari ka përfunduar në depresion dhe nuk ka dal nga shtëpia për disa muaj.

Gjykata duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë, e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet, në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, parimin e *presumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij kodi dhe sipas kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet. Për më tepër, është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ, për më tepër këto parime janë aplikuar në shumë raste edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por që në rastin objekt gjykimi nuk ka pas prova që duhet çmuar në favor të të pandehurve.

Vendimi për Konfiskimi

Konform nenit 269 dhe 271 të KPPK-së, konfiskohet dobia pasurore e përfituar me vepër penale të fajdejes e provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nga i dëmtuari N.L, vlera e dëmit 30.000€uro e shkaktuar vetëm nga pagesa e interesit apo kamata, ndërsa parat e konfiskuar janë si në vijim: 2x200 €uro me numra serik NB1204560558, NZ5700752454, 14x100 €uro me numra serik EA9441823879, EA5873474008, RB3212147921, RB2242769405, RB2961813965, EA8344280395, EA7911881578, EA0787466008, UA6077429481, EA3712544407, EA5013646876, EA1962667477, UA7044181383, VA1776997217, 55x50 €uro me numra serik UB8508334133, EB5145571197, UD3780083223, UC1248897556, UA3867737889, UA3532108584, RC3366887665, EA08611489919, WA5479097905, UC6722683345, UB3073027457, VA7959711674, UA4459966815, PB3664756924, SD1717015223, WB4968601029, WB3293095599, EB1476876717, UC1978556338, SE4291838875, UB8502611699, RE3581806574, RB0358092518, UC5734064161, EB1270936899,

UB5539031417, UA2595643878, VB4733936623, WA0784458208, PB1026703897, RA0107623635, SE1948904821, UC2740766779, RC4692302059, SA6392930909, PB8067082417, UB8704301447, UA7650356088, WB3818771865, NA1307256985, EB2466853857, UA9475171014, ZC4247778713, UB9147367901, RB2957150282, MD2082356036, SB7260359134, RA2734337076, UA9640618716, EB1316333439, SE6708040003, SD3680359958, VC4596814953, UC1827869068, SC7424526153, 14 X 20 Euro me numra serik UA283138G773, UC6454013878, UA0538484844, UF1331276506, UC8652515986, EC0884347352, RA2902819605, PR5981714721, UE9622943567, EN2403415149, UE4371698339, ÜD7367713623, PR6326824743, PR4095506619, 27 X 10 Euro me numra serik EA3592527481, SE9067682764, UD8318783601, YA2717535527, XA0357375078, WB577283571, UD0004283163, EB3638985525, TA0411958462, PA2474455643, YA4350599603, VA1169394464, YA2351164985, VB0702714808, WA1043060086, WB1037983932, FA3981995523, VA5975913404, VB1914501448, VB177420338, SE6027042061, EB0693080406, RB2075873513, PA1130383457, WB0277184025, XA2459173995, UD5001375816, 9 X 5 Euro me numra serik ND1538018107, ND3646610935, ND1538019034, UF6175090654, ZD5026010269, MA2109518471, ND4538018392, ND5646288346, VB8089910416 si dhe 2 X 100 Franga Zvicërane me numër serik 18L4217162 dhe 17D0550885. Paratë do të ruhen në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuara.

Raporti Parandëshkues - Anketa Sociale

Nga raporti para ndëshkues me nr.24119/24-0434-RP të dt.06.12.2024, për të akuzuarin A.G, gjykata gjeti se i njëjti jeton në bashkësi familjare prej nëntë anëtarëve, familja tij kanë kushte mesatare ekonomike, gjendja e banimit është e nivelit mesatare, i pandehuri në aspektin shëndetësor ka rritje dhe zhvillim normal dhe nuk ka përjetuar ndonjë lëndim fisik apo traum psikologjike që mund të ketë ndikuar në formimin e personalitetit të tij, i pandehuri ka raporte të mira me familjare, rrethin ku jeton dhe në punën që ushtron, sa i përket shkollimit ka përfunduar shkollimin e mesëm në Gimnazin “.....” në Ferizaj, është i martuar dhe ka katër fëmijë, si dhe është hera e parë që figuron në evidencat e shërbimit sprovues.

Nga raporti parandëshkues me nr.24119/24-0435-RP të dt.06.12.2024, për të akuzuarin F.G, gjykata gjeti se i njëjti jeton në bashkësi familjare prej nëntë anëtarëve, familja tij kanë kushte mesatare ekonomike, gjendja e banimit është e nivelit mesatare, i pandehuri në aspektin shëndetësor ka rritje dhe zhvillim normal dhe nuk ka përjetuar ndonjë lëndim fisik apo traum

psikologjike që mund të ketë ndikuar në formimin e personalitetit të tij, i pandehuri ka raporte të mira me familjare, rrethin ku jeton dhe në punën që ushtron, është beqar, sa i përket shkollimit ka përfunduar shkollimin e mesëm të lartë në shkollën “.....” në Ferizaj, si dhe është hera e parë që figuron në evidencat e shërbimit sprovues.

Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit, avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka mbet pranë kualifikimin juridik të veprës penale fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-se. Ne shqyrtim gjyqësor është vërtetuar fajësia e të akuzuarve nga dëgjimi i të dëmtuarit N.L, i cili ka dëshmuar për faktet relevante shumat e marra në huazim që nga fillimi e deri në momentin kur është bërë e padurueshme kjo hua, në atë mënyrë që edhe ka vendosur të denoncojë në organet ligj zbatuese të dyshuarit, i dëmtuari përpos që i ka kthyer paratë që i kishte huazuar nga të dyshuarit ka paguar interes në vlerë totale 30.000 euro plus të akuzuarit po i kërkonin edhe 63.000 euro interes, ky fakt është vërtetuar edhe nga fletorja e punës që ju është konfiskuar të akuzuarve e që është e konstatuar me shkrim dhe nënshkrim që obligimi i N.....t është 73.000 euro, ndërsa 10.000 euro po ja falin në mënyrë që ta paguaje këtë shumë deri në fund të vitit 2023.

Mbështetur fillimisht në dëshminë e të dëmtuarit dhe provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor siç janë: vërtetimi mbi konfiskim, masat e veçanta hetimore, prova tjetër materiale siç është shënimi në fletoren me mbishkrim ‘Kep’ dhe vete mbrojtja e të akuzuarve, në si prokurori konsiderojmë që është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, andaj i propozojmë gjykatës që konform nenit 364 të KPPK-se të akuzuarit ti shpalle fajtor dhe ti dënojë sipas ligjit.

Avokati mbrojtës i të dëmtuarit N.L, av. Gazmend Rexhepi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: është vërtetuar pa pike dyshimi se të pandehurit kanë kryer veprën penale si në aktakuze, i dëmtuari me rastin e dëgjimit ka sqaruar në mënyrë të detajuar çështjen se si në vazhdimësi të pandehurit kanë kontraktuar një shumë dukshëm jo proporcionale dhe duke shfrytëzuar pa përvojën e tij dhe po ashtu gjendjen e rëndë ekonomike.

I dëmtuari ka insistuar të dijë se nga kush A..... po i merr paratë me interes që vete i dëmtuari ta paguaje borxhin direkt me ata (për këtë përgjigje nuk ka pasur asnjë kundërshtim).

A.G gjate dëshmisë se tij thotë “ky borxh është krijuar ne fillim te vitit 2021 ne atë mënyrë qe N..... ma ka propozuar një biznes për distribuim te kafes dhe unë ja kam dhënë 25.000 euro, po ashtu edhe 25.000 euro te tjera për një biznes te ri me sprej dhe për këtë i dëmtuari e ka garantuar me banese për te cilën bashke e kane caktuar vlerën e banesës ne shume prej 63.000 euro” ne te njëjtën deklaratë vete i pandehuri Agron me date 31.10.2024 pohon se kane pasur vështirësi financiare konkretisht e thotë ‘jam ngushtuar’, ne mes te këtyre ka mospërputhje mes asaj kur thoshte paratë i kam marre nga baxhanakët sepse punët i kane pasur keq financiarisht kurse ne anën tjetër i ka dhënë para te dëmtuarit N.L dhe i fakturon borxhin 73.000 euro por qe 10.000 po ja fale, si është e mundur me gjithë këtë vështirësi financiare te ja fale 10.000 euro.

Në këtë çështje penale provat janë bindëse, kjo konstatohet edhe ne raport firmues te datës 11.02.2023 nga ana e hetuesve sepse gjate bastisjes janë gjetur edhe prova te tjera ku te pandehurit kane huazuar mjete financiare dhe atë shuma te mëdha po ashtu edhe me rastin e masave te fshehta është vërtetuar fajësia e te akuzuarve andaj i propozoj gjykatës qe ti shpalle fajtores dhe dënoj sipas ligjit.

Avokati mbrojtës i te akuzuarit A.G, av. Fitim Shabani ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nga provat e nxjerra ne shqyrtim gjyqësor me theks te veçante nga dëgjimi i te dëmtuarit nuk është arritur te provohet ndonjë element qe përbën figurën e veprës penale te fajdes, vepra penale e fajdes formohet kur kush do qe për vete apo për personin tjetër pranon ose kontraktin një shume dukshëm jo proporcionale te pasurisë ne këmbim te shërbimit për personin tjetër e duke shfrytëzuar gjendjen e rende financiare te personit te tille, gjendjen e rende te banimit, varfërinë, pa përvojën apo pa aftësinë për te gjykuar. Ne rastin konkret nuk është provuar se i dëmtuari ka paguar shuma jo proporcionale, edhe nëse i referohemi paaftësisë per te gjykuar kjo baze nuk qëndron dhe shihet nga vete deklarimi i te dëmtuarit i cili ka qene kohe me pare ne biznes dhe traqeti dhe ka moshe te konsiderueshme e qe ne një rrethane te tille eventualisht do te mund te thirrej nje person ne gjendje mendore esencialisht të kufizuar. Edhe nga masat e veçanta hetimore te aplikuara ne këtë rast nuk e plotësojnë kushtin themelor për tu cilësuar një vepër e tille si fajde sepse te gjitha raportet ndërmjet te pandehurit Agron dhe te dëmtuarit N..... kane qene te natyrës juridike civile.

Sa i përket detyrimit 63.000 euro dhe pretendimit te 73.000 eurove për këtë pjese i pandehuri Agron dëgjohet duke i thënë te dëmtuarit se 63.000 euro janë aq sa janë marre kurse pjesën e shumes prej 10.000 euro i pandehuri e ka sqaruar se një gjë të tillë i ka thënë të dëmtuarit me arsyetim kinse vete i pandehuri i ka marre këto mjete nga nje person me kamate e qe kjo kamate

nuk do të thotë se është fajde sepse LMD-ja i ka njohur këto kontraktime dhe jo çdo here kur paguhet me tepër se që është marre konsiderohet fajde sepse kamatat, penalltitë dhe vonesat e tjera i njeh LMD-ja.

Sa i përket provës lidhur me fletoren ku është shkruar detyrimi “N.Li ka borxh 73.000 euro A.Gt ky shkrim është shkruar pikërisht në kohën kur i dëmtuari ka pretenduar dhe vendosur të iniciojë procedurën nëpërmjet policisë dhe me qëllim të krijojë alibi dhe kjo sigurisht ka ndodhur në kohën kur kanë filluar masat e veçanta hetimore, i dëmtuari ka pasur qasje të lehtë në atë fletore në lokal mobil shop Toni sepse ka qëndruar me ore të tera në atë lokal.

I pandehuri A.G në mënyrë të qartë ka sqaruar se si është krijuar ky detyrim në mes tij dhe të dëmtuarit, pasi që kishin bashkëpunim në lidhje me servisimin e telefonave tani me është krijuar një shoqëri me e afërt, i pandehuri e ka përkrahur të dëmtuarin në një moment që të angazhohej në një biznes për distribuimin e kafes nga Evropa në Kosovë me një shumë fillestare prej 25.000 euro, kurse pjesën tjetër të mjeteve ja kishte dhënë me pretendimin se i dëmtuari do ta shiste banesën dhe po që se nuk mund ta bënte një gjë të tillë me të pandehurin ka kontraktuar çmimin 63.000 euro, ekuivalente me çmimin e banesës.

Nga audio-inçizimet e nxjerra me rastin e masave të veçanta hetimore vetë i dëmtuari dëgjohet duke i thënë të pandehurit “ti me ke ndihmuar çdo here faleminderit prej teje por unë erdha për këtë pike” cila do të ishte arsyeja apo për qfarë arsye i dëmtuari nuk do të ja thotë të pandehurit që unë erdha në këtë gjendje dhe pozite si pasoje e kamatave që më ngarkove ti, me që e dinte se ishte në masë të fshehta ndërsa i pandehuri nuk dinte këtë rrethana cila ishte arsyeja që të mos ja thoshte. Faktet tjera gjatë këtij audio incizimi është edhe momenti kur i pandehuri i drejtohet të dëmtuarit “unë se di çka dojke me thanë djali, N..... qysh babi gjithë ato, A..... përgjigjet të unë qato, tjera ska, nuk banë me qite në pozite të keqe djalin që me thanë unë i kom qu po kanë mbete qato, unë shumë thjeshtë i thanë nuk po thamë që si ka prurë por sot i ka prurë nesër i ka marre, ti a i ke thanë se këna punu diçka bashkë a çka i ke thanë”.

Nisur nga të gjitha këto rrethana mbrojtja vlerëson se nuk ekziston asnjë element i veprës penale të fajdes, i propozojmë gjykatës që të pandehurin A.G ta liroje nga akuza nga neni 363 par.1 dhe par.3 të KPPK-se.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit F.G, av. Urim Bajraktari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nga provat që janë trajtuar dhe administruar në këtë çështje penale pa mëdyshje u vërtetua se i

pandehuri F.G nuk ka kryer asnjë veprim që do të plotësohen elementet e figurës së veprës penale si në aktakuzë, andaj si rrjedhojë e kësaj rezulton se një akuze e tillë mbetet e pambështetur në prova materiale.

Me rastin e dëgjimit të dëshmitarit N.L krijohet një gjendje e pa qarte dhe e pa qëndrueshme tejet kontradiktore, për të ekzistuar kjo veprë penale duhet që doemos i dëmtuari të ketë gjendje të rëndë financiare, fakti që nuk ka ekzistuar kjo është pohuar nga vete ai në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.10.2024. i dëmtuari kinse për huazim apo kontraktim që ka ndodhur në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit paraqet situatë të ndryshme, nga deklaratimet në dy procesverbalet pranë St. Policor me datë 24.01.2023 thotë “unë N.L para 6 viteve nga F..... dhe A..... kam marrë para me kamate në vlerë prej 2.000 euro që çdo muaj tu japë nga 200 euro ndërsa në shqyrtim gjyqësor 09.10.2024 thotë që me të pandehurin nuk ka pasur marrëveshje paraprake për huazim kontraktimi mirëpo sipas tij pas vonësës së kthimit të shumës së marrë hua e kanë vendosur një kinse shtesë. Tutje dëshmitari ndër të tjera në deklaratën në St. Policor me datë 24.01.2023 thotë “ka ardhë djali im F.... nga Austria dhe të pandehurve u ka paguar shumën prej 17.000 euro”, ndërsa në deklaratim në shqyrtim të datës 09.10.2024 thotë “ka ardhë djali im Faiku i ka sjellë 7.000 euro dhe ja ka dhënë A.....” dilema që shtohet është cila është shuma që ju ka dhënë të pandehurve sepse të dy versionet nuk mund të qëndrojnë dhe të ekzistojnë. Nga prova tjetër materiale CD-ja me masat e veçanta hetimore përveç pretendimeve të dëmtuarit për të cilat vlerësojmë që gjykata assesi nuk mund të marrë për bazë pasi që qëllimi i vetëm është shmangia nga detyrimi që ka në raport me të pandehurin A..... dhe është sqaruar në vijë të trasha që asnjë raport shoqëror apo të punës nuk ka pasur me të pandehurin F.....

Nga mbrojtja e të pandehurit F.G është vërtetuar se merret me shitjen, servisimin e telefonave në mobil shop “Toni” i cili biznes është formalisht në emër të tij por që faktikisht menaxhohet nga vëllai i tij A.G, ka sqaruar edhe mënyrën se i njihen me të dëmtuarin N.L e që nuk ka pasur ndonjë raport të veçantë e ky i fundit ka qenë vetëm shok me vëllain e tij A....., edhe nëse i dëmtuari N..... ka marrë ndonjë telefon, mbushje të telefonit apo të holla huazim këtë e ka bërë pasi i është kërkuar nga ana e bashkë të pandehurit Agron, obligimi që është krijuar në lokal është 2.100 euro dhe pozicioni i F.....t në këtë lokal ishte i barabartë me një punëtor shitës pa të drejtë të tjera menaxhuese.

Me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penale të merr parasysh edhe fenomenin e kohëve të fundit që është paraqitur në vendin tone që është krijimi i detyrimeve dhe arritja në pamundësi të paguhen detyrimet, me pastaj tentimi që përmes inskenimit të situatave të tilla të tentohet të bëjë shmangie të detyrimit duke trilluar kinse situatë të tilla, andaj mbrojtja konsideron që aktakuzë është e pa bazuar dhe e pambështetur në prova materiale dhe procedurale, i propozojmë

gjykatës që të merr aktgjykim lirues ndërsa për konfiskimin e përhershëm të dobisë pasurore të pandehurit F.G e paraqitur në pikën IV të propozimit të refuzohet si e pa bazuar.

Matja dhe caktimi i dënimit

Gjykata konform nenit 356 ka mbajtur seancën për caktim të dënimit, me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit A. dhe F.G, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti sjelljen korrekte në dhe gjatë procedurës duke ndërlidh me faktin se të pandehurin për herë të parë ndodhen në një procedurë penale, respektivisht nuk ka ndonjë vendim të formës së prerë që ndaj tyre është shqiptuar aktgjykim dënues, moshën relativisht të konsiderueshme, janë mbajtës të familjes, me të dëmtuarin kanë pas raporte shoqërore nuk e kanë kërcënuar apo diçka të tillë para dhe pas rastit objekt gjykimi, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata vlerësoj peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, prandaj të akuzuarve ju shqiptoj dënim me burgim nën minimumin e paraparë me ligj dhe dënim me gjobë.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore – juridike dhe shpenzimet procedurale

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të dispozitave të nenit 460 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe procedural është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 449 dhe 450 të KPPK-së.

Vendimi për taksën e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 36 par. 3 pika 3.2 të ligjit Nr. 08/L-109.

Vendimi për konfiskimin përfundimtar të armës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 269 dhe 271 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
2023:083184, të datës 10.01.2025

Zyrtare Ligjore

Kaltrina Luta

Kryetari i trupit gjykues

Ilir BYTYQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.